

# Statistikat afatshkurtra

## Tremujori III, 2014

**Tiranë, më 23 Dhjetor:** INSTAT publikon “Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike”, tremujori i tretë 2014, sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 dhe me bazë të përditësuar, nga 2005 në 2010. Anketa mbulon aktivitetet: *“Industri” (përfshi Industri nxjerrëse dhe Industri përpunuese), “Energji elektrike, gaz, avull”, “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, “Ndërtim”, dhe “Shërbime” (ku përfshihen Tregti, Transport dhe magazinim, Hotele, Informacioni dhe Komunikimi, Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, Agjenci udhëtimi). (Shih shënime metodologjike, fq.21).*

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 127,2 % në tremujorin e tretë 2014.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum pasqyron në aktivitetet ekonomike të mbuluara në anketë, rritje prej 8,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2013. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2013 ishte me rënie 2 %. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët *“Industri”, “Energji elektrike, gaz, avull”, “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, “Ndërtim” dhe “Shërbime”,* përkatësisht me 11,0 %, 7,3 %, -2,3 %, 13,3 % dhe 7,2 %.

Në aktivitetin *“Industri”,* kontributin kryesor në rritjen e shifrës së afarizmit në volum, e jep Industria nxjerrëse me 17,2 %.

Në rritjen prej 7,2 % të shifrës së afarizmit në volum, në *“Shërbime”,* në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013, kanë ndikuar kryesisht aktivitetet: *“Agjenci udhëtimi”* me 35,5 %, *“Hotele”* me 24,8 %, *“Informacioni dhe Komunikacioni”* me 13,0 % dhe *“Tregti”* me 9,2 %.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e tretë 2014, paraqitet me rritje prej 10,3 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët “Industri”, “Energji elektrike, gaz, avull”, “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, “Ndërtim” dhe “Shërbime”, përkatësisht me 5,3 %, -1,7 %, 0,5 %, 7 % dhe 14,1 %.

Në aktivitetin “Industri”, kontributin kryesor në rritjen e shifrës së afarizmit në volum, e jep Industria Përpunuese me 7,1 %.

Në krahasim me tremujorin e dytë 2014, në aktivitetet “Shërbime”, kontributin në rritjen e shifrës së afarizmit në volum, e kanë dhënë aktivitetet si “Transport dhe magazinim” 17,3 %, “Agjenci Udhëtimi” 16,6 %, “Informacion dhe Komunikim” 14,8 %, “Tregti me 14,7 %, “ Hotele” 12,6 %, ndërsa “Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike” ndikojnë me -23,8 %.

**Fig.1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum**





Fig.2 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri, Ndërtim dhe Shërbime



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	III - 13 III - 12	IV - 13 IV - 12	I - 14 I - 13	II - 14 II - 13	III - 14 III - 13
	<b>Aktivitetet ekonomike gjithsej</b>	<b>-2,0</b>	<b>4,7</b>	<b>2,3</b>	<b>2,5</b>	<b>8,7</b>
B+C	Industri	-1,9	11,3	4,2	8,3	11,0
B	Industri nxjerrëse	33,5	68,2	20,5	20,4	17,2
C	Industri përpunuese	-9,7	-1,5	0,2	5,4	9,2
D	Energji elektrike, gaz, avull	14,8	14,0	-3,2	-9,7	7,3
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizim me ujë	38,2	40,0	-2,6	9,8	-2,3
F	Ndërtim	-16,3	-9,3	-2,7	-15,6	13,3
G - N	Shërbime	-0,7	4,8	4,3	6,8	7,2
G	Tregti	-1,0	5,8	5,5	7,0	9,2
H (49-53)	Transport dhe magazinim	18,9	-22,7	-36,2	-27,4	-31,1
I (551)	Hotele	-14,3	-22,0	-5,8	19,7	24,8
J (58-62)	Informacioni dhe komunikimi	-15,9	4,5	9,9	20,2	13,0
M (71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	70,0	59,8	57,7	47,6	2,0
N (79)	Agjenci udhëtimi	3,3	41,4	30,6	37,0	35,5

**Tab. 2 Ndryshimi tremujori i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	III -13 II - 13	IV - 13 III - 13	I - 14 IV - 13	II - 14 I - 14	III - 14 II - 14
	<b>Aktivitetet ekonomike gjithsej</b>	<b>4,0</b>	<b>7,7</b>	<b>-18,6</b>	<b>12,4</b>	<b>10,3</b>
B+C	Industri	2,7	6,2	-14,6	16,2	5,3
B	<i>Industri nxjerrëse</i>	1,0	22,9	-16,8	16,7	-1,7
C	<i>Industri përpunuese</i>	3,3	1,0	-12,9	16,1	7,1
D	Energji elektrike, gaz, avull	-17,3	10,2	13,1	-12,4	-1,7
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	12,9	1,5	-11,7	8,5	0,5
F	Ndërtim	-20,4	21,4	-27,6	20,5	7,0
G - N	Shërbime	13,8	5,4	-21,0	12,7	14,1
G	<i>Tregti</i>	12,4	6,1	-21,2	13,8	14,7
H (49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	23,6	-40,2	-21,8	25,5	17,3
I (551)	<i>Hotele</i>	8,0	-7,2	-17,5	44,7	12,6
J (58-62)	<i>Informacion dhe komunikim</i>	22,2	34,1	-25,8	-1,1	14,8
M (71)	<i>Aktivite arkitekture dhe inxhinierike</i>	10,2	6,4	21,0	4,0	-23,8
N (79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	17,8	14,2	-14,9	19,7	16,6

## Industri, Energji dhe Ujë

Në tremujorin e tretë 2014, **në ndryshim vjetor**, indeksi i shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “Industri” (përfshirë Industrinë nxjerrëse dhe përpunuese) është rritur 11 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013. Në këtë rritje ndikoi aktiviteti “Industri nxjerrëse” me 17,2 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, aktiviteti “Energji elektrike, gaz, avull” paraqitet me rritje 7,3 %, ndërsa aktiviteti “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” me rënie 2,3 %.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “Industri”, paraqitet me rritje 5,3 %. Në këtë rritje ndikoi kryesisht aktiviteti “Industri përpunuese” me 7,1 %.

Aktiviteti “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” shënoi rritje me 0,5 %, ndërsa aktiviteti “Energji elektrike, gaz, avull” shënoi rënie me 1,7 %.

Krahasuar me tremujorin e tretë 2013, **në ndryshim vjetor**, volumi i prodhimit industrial në “Industri” shënoi një rritje prej 12 %, ku të dy aktivitetet si “Industri nxjerrëse” dhe “Industri përpunuese” kanë ndikuar, përkatësisht me 11,6 % secila.

Ndërsa, aktivitetet “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” dhe “Energji elektrike, gaz, avull” shënuan rënie përkatësisht me 10,5 % dhe 5,3 %.

Gjatë tremujorit të tretë 2014, **në ndryshim tremujor**, volumi i prodhimit industrial shënoi një rritje me 9,9 % krahasuar me tremujorin paraardhës, ku ndikimin më të madh e ka dhënë “Industria nxjerrëse” me 13,7 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, volumi i prodhimit në “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” shënoi një rritje me 22,4 %, ndërsa Volumi i prodhimit në “Energji elektrike, gaz, avull” shënoi rënie me 44 %.

Gjatë tremujorit të tretë 2014, **në ndryshim vjetor**, numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “Industri” (Industri nxjerrëse dhe përpunuese) u rrit me 20,8 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në “Industri përpunuese” me 22,3 %.

Për aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, ky tregues paraqitet me rritje 6,4 % dhe 2,4 %.

Me një rritje prej 0,8 % rezulton **në ndryshim tremujor**, numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “Industri”, rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i aktivitetit “Industri nxjerrëse” me 11,8 %.

Ky tregues paraqitet respektivisht me rënie 1,1 % në aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” dhe 0,2 % në aktivitetin “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”.


Gjatë tremujorit të tretë 2014, niveli i fondit të pagave shënoi, **në ndryshim vjetor**, një rritje prej 20,4 % në “Industri”, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në “Industri nxjerrëse” me 23,1 %.

Në aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, ky tregues u rrit përkatësisht me 13,1 % dhe 11,8 %.


Fondi i pagave, **në ndryshim tremujor**, shënoi rritje me 5,8 % në aktivitetin “Industri”, rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i aktivitetit “Industri nxjerrëse” me 23,8 %.

Ky tregues shënoi rënie në aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, përkatësisht me 2,9 % dhe 5,6 %.


**Fig. 3 Indeksi i shifrës së afarizmit dhe prodhimit industrial në Industri nxjerrëse dhe përpunuese**  
(2010=100) (%)



**Fig. 4 Indeksi i shifrës së afarizmit në Industri nxjerrëse, Industri përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi dhe furnizimi me ujë**



**Fig. 5 Sasia e prodhimit të Energjisë elektrike në (000/kw-orë)**



**Tab. 3 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
B-C	05-33	Industri	-1,9	11,3	4,2	8,3	11,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	33,5	68,2	20,5	20,4	17,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-9,7	-1,5	0,2	5,4	9,2
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	14,8	14,0	-3,2	-9,7	7,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	38,2	40,0	-2,6	9,8	-2,3

**Tab. 4 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	2,7	6,2	-14,6	16,2	5,3
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	1,0	22,9	-16,8	16,7	-1,7
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	3,3	1,0	-12,9	16,1	7,1
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	-17,3	10,2	13,1	-12,4	-1,7
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	12,9	1,5	-11,7	8,5	0,5

**Tab. 5 Ndryshimi vjetor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
B-C	05-33	Industri	13,7	25,3	21,3	4,3	12,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	34,4	56,9	20,4	0,9	11,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-2,7	-0,6	20,0	6,1	11,6
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	35,0	87,8	-18,0	-38,0	-5,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	28,6	-8,9	-7,9	-0,4	-10,5



**Tab. 6 Ndryshimi tremujor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	2,4	2,8	3,9	-4,6	9,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	2,8	12,9	-8,8	-4,6	13,7
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	1,9	-8,5	19,2	-4,5	7,2
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	-63,4	35,7	14,7	8,7	-44,0
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	36,2	-25,7	-11,0	10,5	22,4

**Tab. 7 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			III - 13	IV - 13	I - 13	II - 14	III - 13
B-C	05-33	Industri	9,9	10,3	15,7	21,0	20,8
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	22,9	18,4	4,0	-0,3	12,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	7,7	8,9	17,5	24,8	22,3
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	8,2	12,0	10,6	8,8	6,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	11,2	14,8	3,2	6,1	2,4

**Tab. 8 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	0,9	3,0	13,3	2,7	0,8
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-1,3	-2,3	3,8	-0,4	11,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	1,3	4,0	14,7	3,2	-0,7
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	1,1	-0,9	7,9	0,6	-1,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	3,4	1,0	0,6	1,0	-0,2

**Tab. 9 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
B-C	05-33	Industri	25,0	21,7	13,5	18,5	20,4
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	54,2	41,3	-0,1	6,3	23,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	12,2	13,1	18,7	23,9	19,8
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	27,8	14,5	23,8	24,3	13,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	10,4	33,0	-2,5	8,7	11,8

**Tab. 10 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë**

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	4,2	1,4	6,0	5,9	5,8
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	6,8	-4,2	-6,8	11,4	23,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	2,6	4,8	10,9	3,9	-0,8
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	6,7	1,6	8,1	6,1	-2,9
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	-8,2	16,5	-7,0	9,3	-5,6

# Ndërtimi


Në aktivitetin e “Ndërtimit”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e tretë 2014 shënoi një rritje prej 13,3 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndërsaq volumi i ndërtimit paraqitet me një rritje prej 14,4 %.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e Ndërtimit në tremujorin e tretë 2014 paraqitet me një rritje prej 19,8 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, fondi i pagave shënoi një rritje prej 2,4 % gjatë së njëjtës periudhë.

Në tremujorin e tretë 2014, **ndryshmi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, shënoi një rritje prej 7 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndërsaq volumi i ndërtimit është rritur me 4,3 % gjatë së njëjtës periudhë.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e “Ndërtimit” në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2014, paraqitet me rritje prej 4 %, ndërsaq fondi i pagave shënoi një rritje prej 1 %.

**Fig. 6** Indekset e shifrës së afarizmit dhe volumit të ndërtimit



Tab. 11 Ndryshimi vjetor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100)

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
41-43	Shifra e afarizmit	-16,3	-9,3	-2,7	-15,6	13,3
	Volumi i ndërtimit	-15,8	-10,1	-1,2	-10,3	14,4
	Të punësuar me pagesë	-5,8	2,0	8,3	15,6	19,8
	Fondi i pagave	15,4	20,5	0,8	10,8	2,4

Tab. 12 Ndryshimi tremujor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100)


(%)

NVE Rev.2	Treguesit	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
41-43	Shifra e afarizmit	-20,4	21,4	-27,6	20,5	7,0
	Volumi i ndërtimit	-18,2	16,0	-28,2	31,7	4,3
	Të punësuar me pagesë	0,4	0,2	14,3	0,5	4,0
	Fondi i pagave	9,2	-4,3	4,2	1,7	1,0

Fig. 7 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike

(2010=100)

(%)



## Shërbime

Në tremujorin e tretë 2014, **në ndryshim vjetor**, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “Shërbime” është rritur 7,2 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet: “Agjenci udhëtimi”, me 35,5 %, “Hotele” me 24,8 %, dhe “Informacioni dhe komunikacioni” me 13 %. Në aktivitetet “Transport dhe magazinim”, ku përfshihet dhe aktiviteti “Postë”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013, paraqitet me rënie prej 31,1 %.

Në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin dytë 2014, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet e “Shërbimeve” është rritur 14,1 %. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet: “Transport dhe magazinim” me 17,3 %, “Agjenci udhëtimi” me 16,6 %, “Tregti me shumicë” me 16,2 %, etj. Në “Aktivitete të arkitekturës dhe inxhinierike”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, paraqitet me rënie prej 23,8 % në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

Në tremujorin e tretë 2014, **në ndryshim vjetor**, në aktivitetin “Shërbime” ka pasur një rritje të numrit të punësuarve me pagesë me 14,6 %. Kontributin në këtë rritje e kanë dhënë aktivitetet “Hotele” me 27,4 %, “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” me 21,6 %, “Tregti me shumicë” me 17,6 %, etj. Ndërsa, aktiviteti “Transport dhe magazinim” paraqitet me rënie 2,9 %.

Në tremujorin e tretë 2014, **në ndryshim tremujor**, në ndërmarrjet e aktivitetit “Shërbime” ka pasur ulje të numrit të punësuarve me pagesë me 2,5 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Në këtë rënie kanë ndikuar aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi automjeteve dhe motoçikletave” me 11,8 %, “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” me 10 %. Ndërsa, aktiviteti “Hotele” paraqitet me 14,7 % rritje në këtë tregues.

Në aktivitetin “Shërbime”, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e tretë 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kontribut kryesor në rritje në këtë tregues kanë dhënë aktivitetet “Hotele” me 25 %, “Informacioni dhe komunikacioni” me 23,7 %, “Tregti me shumicë” me 17,9 %, etj.

Në aktivitetin “Shërbime”, në tremujorin e tretë 2014, **në ndryshim tremujor**, fondi i pagave paraqitet me rënie 6,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Në këtë rënie kanë ndikuar aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” me 8,1 %, “Informacioni dhe komunikacioni” me 6,4 %. Aktivitetet si “Hotele” dhe “Agjenci udhëtimi” paraqesin rritje përkatësisht me 11,5 % dhe 2 %.

### **Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregtia me shumicë**

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013, në aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” dhe “Tregti me shumicë” është rritur përkatësisht me 7,3 % dhe 8,0 %.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” dhe “Tregti me shumicë” është rritur përkatësisht me 7,7 % dhe 16,3 %, në tremujorin e tretë 2014 në krahasim me tremujorin dytë 2014.

Në tremujorin e tretë 2014, në ndërmarrjet e aktivitetit “Tregti me shumicë”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë paraqet rritje 17,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

Ndërsa, **në ndryshim tremujor**, ky tregues paraqet rritje 4,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Në aktivitetin “Tregti me shumicë”, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e tretë 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 17,9 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa në aktivitetin “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” ka patur rënie me 2,7 %.

**Në ndryshim tremujor**, ky tregues paraqet rritje 0,6 % në aktivitetin “Tregti me shumicë”, ndërsa në aktivitetin “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” ka patur rënie me 8,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

### **Transporti dhe Magazinimi (përfshirë dhe aktiviteti “Postë”)**

Në aktivitetet “Transporti dhe magazinimi”, ku përfshihet dhe aktiviteti “Postë”, shifra e afarizmit në volum, ka pësuar rënie me 31,1 %, në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013, si rezultat i ndikimit negativ të aktivitetit “Transport ajror”. Brenda këtij aktiviteti, në aktivitetin “Postë”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, krahasuar me tremujorin e tretë 2013, është rritur me 8,4 %.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “Transport dhe magazinim”, përfshirë dhe aktivitetin “Postë”, është rritur 17,3 %. Në aktivitetin postë, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e dytë 2014 paraqet ulje 0,5 %.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Transport dhe magazinim” paraqet rënie me 2,9 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

Ndërsa, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e “Transport dhe magazinim” në **ndryshim tremujor**, paraqet rritje 1,3 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Referuar të njëjtit aktivitet, **në ndryshim vjetor**, indeksi i fondit të pagave paraqitet me rënie 17 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë 2014, indeksi i fondit të pagave paraqet rënie 5,3 %, në aktivitetin “Transport dhe magazinim”.

### **Hotele**

Në aktivitetin “ Hotele”, **në ndryshim vjetor**, shifra e afarizmit në volum, rritet 24,8 % në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

Në tremujorin e tretë 2014, në aktivitetin “Hotele”, krahasuar me tremujorin e dytë 2014, indeksi i shifrës së afarizmit në volum paraqet rritje 12,6 %.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në tremujorin e tretë 2014 paraqet rritje 27,4 %, ndërkaj në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ky tregues paraqet rritje 14,7 %.

Fondi pagave, **në ndryshim vjetor**, në ndërmarrjet e aktivitetit “Hotele” paraqitet me rritje 25 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndërkaj në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ky tregues paraqet rritje 11,5 %.

### **Informacioni dhe Komunikacioni**

Në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, është rritur 13 % në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetet “Informacioni dhe Komunikacioni”, paraqitet me rritje 14,8 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë, në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni”, në **ndryshim vjetor**, paraqitet me rritje 18,3 %, në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë referuar të njëjtit aktivitet “Informacioni dhe komunikacioni” paraqitet me ulje 0,3 %.

Fondi i pagave në aktivitetin “Informacioni dhe komunikacioni”, paraqitet me rritje 23,7 %, ndërsa ndryshimi tremujor i indeksit të fondit të pagave paraqet rënie 6,4 %.

**Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike**

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në “Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike” rritet 2 % në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rënie me 23,8 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Aktivite arkitekture dhe inxhinierike” paraqet rritje 21,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndërsa në **ndryshim tremujor**, referuar të njëjtit aktivitet, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë paraqitet me rënie me 10 %.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të fondit të pagave në aktivitetin “Aktivite arkitekture dhe inxhinierike” paraqet rritje 13,7 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

Me rritje 0,2 % paraqitet indeksi i fondit të pagave në këtë tremujor, referuar të njëjtit aktivitet, krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

**Agjencitë e udhëtimit**

Në aktivitetin “Agjenci e udhëtimi”, shifra e afarizmit në volum, rritet 35,5 % në tremujorin e tretë 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2013.

**Ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje 16,6 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

**Ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Agjenci udhëtimi” paraqet rënie 1,5 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndërsa në **ndryshim tremujor**, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në këtë aktivitet paraqet rritje 2 %.

Indeksi i fondit të pagave, në **ndryshim vjetor**, në aktivitetin “Agjenci udhëtimi” paraqet rënie 10 % krahasuar me tremujorin e tretë 2013, ndërsa në **ndryshim tremujor**, ky tregues paraqitet me rritje 2 %.



**Tab. 13 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
G-N	Shërbime	-0,7	4,8	4,3	6,8	7,2
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	1,1	-3,1	-2,2	0,2	7,3
G(46)	Tregtia me shumicë	-0,8	7,2	5,3	6,5	8,0
H(49-53)	Transport dhe magazinim	18,9	-22,7	-36,2	-27,4	-31,1
I(5500)	Hotele	-14,3	-22,0	-5,8	19,7	24,8
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	-15,9	4,5	9,9	20,2	13,0
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	70,0	59,8	57,7	47,6	2,0
N(79)	Agjenci udhëtimi	3,3	41,4	30,6	37,0	35,5


**Tab. 14 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
G-N	Shërbime	13,8	5,4	-21,0	12,7	14,1
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	0,6	-2,5	-3,1	5,3	7,7
G(46)	Tregtia me shumicë	14,6	6,5	-24,4	15,5	16,3
H(49-53)	Transport dhe magazinim	23,6	-40,2	-21,8	25,5	17,3
I(5500)	Hotele	8,0	-7,2	-17,5	44,7	12,6
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	22,2	34,1	-25,8	-1,1	14,8
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	10,2	6,4	21,0	4,0	-23,8
N(79)	Agjenci udhëtimi	17,8	14,2	-14,9	19,7	16,6

**Fig. 8** Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë dhe fondi i pagave, në Shërbime



**Tab. 15** Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(2010=100) (%)

Kodi	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
NVE Rev.2		III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
G-N	Shërbime	5,5	8,2	6,8	16,3	14,6
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	4,6	6,1	9,8	17,4	3,9
G(46)	Tregtia me shumicë	10,7	11,6	9,5	12,8	17,6
H(49-53)	Transport dhe magazinim	2,1	-4,4	-4,7	-4,4	-2,9
I(5500)	Hotele	0,4	4,5	8,9	23,3	27,4
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	-26,5	-19,8	-13,5	11,4	18,3
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	49,7	82,1	22,7	37,7	21,6
N(79)	Agjenci udhëtimi	18,4	30,3	0,7	2,7	-1,5

**Tab. 16 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
G-N	Shërbime	-1,0	2,5	8,7	5,5	-2,5
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	-0,3	0,9	6,2	9,9	-11,8
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	-0,2	2,4	9,1	1,2	4,1
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	-0,3	-7,1	3,2	0,1	1,3
I(5500)	<i>Hotele</i>	11,1	-9,9	14,9	7,3	14,7
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikacioni</i>	-6,1	9,7	4,7	3,3	-0,3
M(71)	<i>Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike</i>	2,0	27,9	0,4	5,1	-10,0
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	6,3	-1,7	1,9	-3,5	2,0

**Tab. 17 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
		III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13
G-N	Shërbime	7,9	10,7	4,1	11,6	7,0
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	7,6	13,5	5,3	7,9	-2,7
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	15,6	14,6	4,0	14,8	17,9
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	14,4	-11,6	-14,8	-6,5	-17
I(5500)	<i>Hotele</i>	8,4	10,7	9,1	22,5	25,0
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikacioni</i>	-21,5	0,5	12,1	17,9	23,7
M(71)	<i>Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike</i>	33,1	71,1	6,8	14,7	13,7
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	39,2	53,4	-11,3	-10,1	-10,0

**Tab. 18 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime**

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	III - 13	IV -13	I - 14	II - 14	III - 14
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
G-N	Shërbime	-2,4	4,3	6,7	2,6	-6,4
G(45)	<i>Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	1,8	3,7	-3,7	6,1	-8,1
G(46)	<i>Tregtia me shumicë</i>	-2,0	0,7	10,4	5,5	0,6
H(49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	6,7	-18,4	2,8	4,4	-5,3
I(5500)	<i>Hotele</i>	9,2	-7,6	10,7	9,7	11,5
J(58, 61, 62)	<i>Informacioni dhe komunikacioni</i>	-10,8	28,6	9,8	-6,4	-6,4
M(71)	<i>Aktivite arkitekture dhe inxhinierike</i>	1,0	30,7	-8,3	-5,3	0,2
N(79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	1,9	3,5	-14,5	-0,2	2,0

# Metodologjia

## Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, publikon indekset e treguesve ekonomike si Shifër afarizmi, Prodhim, Numri i të punësuarve me pagesë dhe Paga për aktivitetet Industri, (ku përfshihen Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, gaz, avull; Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë; Ndërtim dhe Shërbime, ku përfshihen (Tregti; Transport dhe magazinim; Hotele; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi).

Në Tregti, anketa mbulon aktivitetet Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregti me shumicë. Treguesit e Tregtisë me pakicë publikohen më vete. Për më shumë informacion, linku: <http://www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet/publication/books/2014/tregtia-me-pakicë,-t3-2014.aspx>;

Ndryshimet metodologjike i referohen:

- Aplikimit të Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimit, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga 2005 në 2010
- Ri-referimit, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

**Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2**, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: [http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim\\_per\\_media\\_-\\_ndryshimi\\_i\\_nomenklatur\\_s\\_s\\_veprimtarive\\_ekonomike\\_rev\\_2.pdf](http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf)

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njësive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivitetet publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e “Publikimit” përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) “Aktivitete publikimi” përkon me ndarjen 58, seksioni J, “Informacioni dhe Komunikacioni”.
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e “Ndërtimit”, detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, “Ndërtimi i ndërtesave”, 42, “Punime inxhinierike” dhe 43 “Punime të specializuara ndërtimi”. Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin “Aktivitete mbi pasuritë e patundshme”.
- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteteve si: “Grumbullimi dhe Trajtimi i mbeturinave”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivitete i përkojnë ndarjes 38, “Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, aktivitete të kontroleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivitete të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivitete të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

**Informacion mbi vrojtimin**

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë (36)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazininim, Agjenci udhëtimit, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazininimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

#### **Përkufizimet e treguesve kryesorë**

**Shifra e afarizmit** - Shifra e afarizmit përfshin shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

**Indeksi i Shifrës së afarizmit** - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

**Numri i të punësuarve me pagesë** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

**Indeksi i Numrit të punësuarve me pagesë** - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

**Paga dhe trajtime** - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

**Indeksi i fondit të pagave** - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.